



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

Raporti i rregullt i punës
GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Prill-Qershor 2023

Bazuar në nenin 14, pika 2 nën pika 2.5 të Ligjit për Gjykatat dhe pika 5 e nenit 11 të Rregullores Nr. 02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, Nënkryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan paraqet raportin e rregullt të punës.

Raporti i rregullt i punës së Gjykatës Themelore në Gjilan përfshinë periudhën raportuese nga 1 Prill deri më 30 Qershor 2023.

I. Hyrje

Raporti i Gjykatës Themelore të Gjilanit paraqet të gjitha të dhënat statistikore për këtë periudhë, të arriturat, sfidat, por edhe pengesat që kanë qenë gjatë kësaj periudhe.

Ky raport është i bazuar në detyrat dhe objektivat e projektuara dhe të përcaktuara paraprakisht me Planin Vjetor të Punës, Planet Periodike dhe Planin Strategjik Operativ të Gjykatës.

II. Struktura e Gjykatës Themelore në Gjilan me Degët e saja

Në Gjykatën Themelore të Gjilanit së bashku me Degët e saj në Kamenicë, Viti dhe Novobërdë, janë gjithsejtë 35 gjyqtarë (përfshirë edhe kryetarin e gjykatës), të caktuar në departamente dhe divizione.

Gjykata Themelore në Gjilan – Selia, aktualisht ka 23 gjyqtarë (përfshirë edhe kryetarin e gjykatës).

Në Departamentin e Krimeve të Rënda aktualisht janë 6 gjyqtarë, në Departamentin për të Mitur punon 1 gjyqtar, ndërsa në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal punojnë 5 gjyqtarë, në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil punojnë 8 gjyqtarë dhe në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Kundërvajtjes punojnë 2 gjyqtar. Po ashtu me ndryshimin e planit të punës të miratuar edhe nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës është paraparë që dy gjyqtarë të ngarkohen me lëndët e Divizionit Civil me të cilat ka qenë i ngarkuar gjyqtari Millorad Mitković i cili në muajin prill të këtij viti ka dal në pension si dhe 2 të tjerë të ngarkohen me lëndët e Divizionit Penal me të cilat ka qenë e ngarkuar gjyqtarja Snezhana Mihajlović e cila në muajin dhjetor të këtij viti do të dal në pension.

Po ashtu gjyqtari Boban Aleksić i cili ka punuar në degën e kësaj gjykate në Novobërdë tanimë me ndryshimin e planit të punës të miratuar edhe nga KGJK është paraparë që 2 ditë të punoj lëndë të Divizionit Civil të natyrës përmbareme në Gjykatën Themelore në Gjilan.

Dega e Gjykatës Themelore në Kamenicë: Kjo degë aktualisht ka 4 gjyqtarë, ku me ndryshimin e planit të punës tanim në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal do të punoj vetëm 1 gjyqtar i cili do ti kryejë edhe lëndët kundërvajtëse dhe 3 gjyqtarë në Divizionin Civil, por njëri prej tyre është caktuar që ti kryej vetëm lëndët e shujtave dhe pagave jubilarë si dhe procedurën paraprake në Divizionin Penal.

Po ashtu gjyqtari Boban Aleksiç i cili ka punuar në degën e kësaj gjykate në Novobërdë tanimë me ndryshimin e planit të punës të miratuar edhe nga KGJK është paraparë që 3 ditë të punoj lëndë të Divizionit Civil në degën e kësaj gjykate në Kamenicë ku i njejtë do të ngarkohet me 25 % të lëndëve kontestimore me të cilët janë të ngarkuar gjyqtarët e tjerë të kësaj dege dhe në këtë divizion duke mos i llogaritur lëndët ku objekt i kontestit janë pagat jubilarë, shujtat dhe të ngjashme pasi këto lëndë do ti gjykojë gjyqtarja Valbonë Dërvodelli.

Dega e Gjykatës Themelore në Viti: Në këtë degë kemi aktualisht kemi 7 gjyqtarë, prej tyre 2 gjyqtarë në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal ndërsa 5 gjyqtarë në Divizionin Civil, ku është planifikuar që në divizionin civil ndërsa me ndryshimin e planit të punës është vendosur që edhe 6 gjyqtar nga Gjykata Themelore në Gjilan të transferohen përkatësisht të kryejnë edhe lëndë në Degën e Vitisë dhe atë 3 prej tyre në Divizionin Penal, 2 në Divizionin Civil dhe 1 gjyqtar në Divizionin Kundërvajtës ku tanimë është duke u bërë identifikimi i lëndëve me të cilat do të ngarkohen të njejtë.

Dega e Gjykatës Themelore në Novobërdë: Në këtë degë kemi 1 gjyqtar i cili do të gjykojë lëndë të Divizionit Civil, ndërsa lëndë penale i gjykon gjyqtari i Gjykatës Themelore në Gjilan, Ramiz Azizi.

Gjyqtari Boban Aleksiç i cili ka punuar në këtë degë tanimë me ndryshimin e planit të punës të miratuar edhe nga KGJK është paraparë që i njejtë 3 ditë të punoj lëndë të Divizionit Civil në degën e kësaj gjykate në Kamenicë dhe 2 ditë të tjera në Gjykatën Themelore në Gjilan po ashtu lëndë të Divizionit Civil.

Në Gjykatën Themelore të Gjilanit, lëndët ndahen me Sistemin e Programit SMIL, ashtu siç është caktuar me Rregulloren mbi veprimtarinë e gjykatave.

III. Raportet statistikore

Të dhënat statistikore i kemi të paraqitur në formë tabelare të cilat janë të nxjerra nga Programi SMIL.

Gjykata Themelore Gjilan	Lëmia	Lëndët e trashëguara I	<u>Lëndët e ardhura</u> II	Gjithsejtë lëndët në punë III	<u>Lëndët e krvera</u> IV	Lëndët e mbetura V	<u>Përqindja e lëndëve të ardhur dhe të zgjidhura</u> II – IV
Dep. Krimeve të Rënda	Paraprake	261	<u>55</u>	316	<u>46</u>	270	<u>84 %</u>
	Penale	491	<u>65</u>	556	<u>65</u>	491	<u>100 %</u>
Dep. Përgjithshëm	Paraprake	484	<u>55</u>	539	<u>45</u>	494	<u>82 %</u>
	Penale	1775	<u>245</u>	2020	<u>302</u>	1718	<u>123 %</u>
	Civile	4390	<u>571</u>	4961	<u>509</u>	4452	<u>89 %</u>
	Jashtëkontestimore	136	<u>64</u>	200	<u>50</u>	150	<u>78 %</u>
	Përmbarimore	458	<u>243</u>	701	<u>145</u>	556	<u>60 %</u>
	Përgatitore për të mitur	29	<u>3</u>	32	<u>2</u>	30	<u>67 %</u>
Dep. për të Mitur	Penale para kolegjit	110	<u>23</u>	133	<u>31</u>	102	<u>135 %</u>
Divizioni Kundërvajtjes	Kundërvajtje	1721	<u>501</u>	2222	<u>353</u>	1869	<u>70 %</u>
	TOTALI	9855	<u>1825</u>	11680	<u>1548</u>	10132	<u>84 %</u>

Dega e Themelores Kamenicë	Lëmia	Lëndët e trashëguara I	<u>Lëndët e ardhura</u> <u>II</u>	Gjithsejtë lëndët në punë III	<u>Lëndët e kryera</u> <u>IV</u>	Lëndët e mbetura V	<u>Përqindia e lëndëve të ardhur dhe të zgjidhura</u> <u>II – IV %</u>
Dep. Përgjithshëm	Paraprake	79	<u>16</u>	95	<u>12</u>	83	<u>75 %</u>
	Penale	388	<u>31</u>	419	<u>79</u>	340	<u>255 %</u>
	Civile	1227	<u>167</u>	1394	<u>72</u>	1322	<u>43 %</u>
	Jokontestimore	47	<u>2</u>	49	<u>1</u>	48	<u>50 %</u>
	Përmbaremore	164	<u>65</u>	229	<u>92</u>	137	<u>142 %</u>
	Kundërvajtje	352	<u>32</u>	384	<u>76</u>	308	<u>238 %</u>
	TOTALI	2257	<u>313</u>	2570	<u>332</u>	2238	<u>106 %</u>

Dega e Themelores Viti	Lëmia	Lëndët e trashëguara	<u>Lëndët e ardhura</u>	Gjithsejtë lëndët në punë	<u>Lëndët e kryera</u>	Lëndët e mbetura	<u>Përqindja e lëndëve të ardhur dhe të zgjidhura</u> <u>II – IV %</u>
Dep. Përgjithshëm	Paraprake	41	<u>27</u>	68	<u>19</u>	49	<u>70 %</u>
	Penale	1447	<u>118</u>	1565	<u>144</u>	1421	<u>122 %</u>
	Civile	3533	<u>243</u>	3776	<u>227</u>	3549	<u>93 %</u>
	Jokontestimore	48	<u>6</u>	54	<u>11</u>	43	<u>183 %</u>
	Përmbaremore	487	<u>64</u>	551	<u>76</u>	475	<u>119 %</u>
	Kundërvajtje	772	<u>162</u>	934	<u>0</u>	934	<u>0 %</u>
	TOTALI	6328	<u>620</u>	6948	<u>477</u>	6471	<u>76 %</u>

Dega e Themelores Novobërdë	Lëmia	Lëndët e trashëguara	<u>Lëndët e ardhura</u>	Gjithsejtë lëndët në punë	<u>Lëndët e kryera</u>	Lëndët e mbetura	<u>Përqindja e lëndëve të ardhur dhe të zgjdhura</u> <u>II – IV %</u>
Dep. Përgjithshëm	Paraprake	11	<u>0</u>	11	<u>0</u>	11	<u>0 %</u>
	Penale	162	<u>12</u>	174	<u>31</u>	143	<u>258 %</u>
	Civile	341	<u>71</u>	412	<u>82</u>	330	<u>115 %</u>
	Jokontestimore	166	<u>9</u>	175	<u>48</u>	127	<u>533 %</u>
	Përmbartimore	40	<u>22</u>	62	<u>8</u>	54	<u>36 %</u>
	Kundërvajtje	124	<u>40</u>	164	<u>30</u>	134	<u>75 %</u>
TOTALI		844	<u>154</u>	998	<u>199</u>	799	<u>129 %</u>

Statistikat e përgjithshme

Gjykata Themelore Gjilan së bashku me Degët

	Lëndët e trashëguara	<u>Lëndët e ardhura</u>	Gjithsejtë lëndët në punë	<u>Lëndët e kryera</u>	Lëndët e mbetura	<u>Përqindja e lëndëve të ardhur dhe të zgjidhura %</u>
Totali	19284	2912	22196	2556	19640	87 %

IV. Përmbushja e objektivave

a) **Zvogëlimi i ngarkesës së lëndëve për gjyqtarë dhe ndarja e tyre:** në tremujorin e dytë të këtij viti kemi tentuar që të inkurajojmë sa ma tepër gjyqtarët që të njëjtit të caktojnë dhe përfundojnë lëndët sa më shumë që është e mundur si në Divizionin Penal dhe atë Civil dhe mund të konsiderojmë se është punuar, por ka hapësirë edhe më tepër të punohet. Si sfidë e kësaj gjykate në këtë tre mujour ka qenë në Divizionin Civil, për shkak të ngarkesës në këtë divizion dhe siç e dini në ndryshimin e Planit të Punës kemi bërë disa ndryshime për 6 mujourin e dytë të këtij viti dhe do të presim rezultate pozitive. Në të kaluarën siç kemi raportuar sfidë kanë qenë lëndët e vjetra dhe lëndët e kthyer në rigjykim ku disa herë në kolegjiunet e gjyqtarëve është kërkuar që të veprohet në bazë të strategjive dhe të i trajtojnë çështjet sipas prioriteteve të cilat i jep ligji dhe sipas rendit të ardhjes së gjykatë të lëndëve, e jo të i zgjedhin lëndët e natyrës sa më të lehtë.

Gjithashtu nga gjithë gjyqtarët të kësaj gjykate është kërkuar që të rrisin efikasitetin, duke angazhuar bashkëpunëtorët profesional, pasi që në Divizionin Civil, secili gjyqtar ka të caktuar një bashkëpunëtor, kurse në Divizionin Penal momentalisht janë të ndarë një bashkëpunëtor punon për 2 gjyqtarë.

b) Sa i përket Departamentit për Krime të Rënda është kërkuar nga gjyqtarët të caktojnë sa më tepër lëndë që është e mundur dhe tu jepet prioritet lëndëve të vjetra, atyre të kthyer në rigjykim dhe natyrës së korrupsionit me ç'rast që të gjitha 17 lëndët e kësaj natyre tanimë janë në punë.

c) Rritja e transparencës së gjykatës: ishte si objektivë e gjykatës sonë që gjatë kësaj periudhe të kontribuojmë edhe më tepër në rritje të transparencës me qytetarët, institucionet dhe me shoqërinë civile. Kemi pranuar disa kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, pyetje të gazetarëve dhe ju kemi përgjigjur brenda afatit kërkesave, gjithashtu kemi takuar qytetarë, avokatë përfaqësues të OJQ-ve, si dhe kemi bërë përpjekje për të publikuar sa më tepër vendime gjyqësore.

V. Identifikimi i problemeve me të cilat është ballafaquar gjykata

Disa nga sfidat të cilat janë paraqitur gjatë muajve prill-qershor të vitit 2023, janë të ngjashme me tremujorshit paraprak edhe atë si më poshtë:

a) Staf i administrati përkatësisht zyrtarët ligjorë – sekretarët juridike ku disa prej tyre janë në moshë të shtyrë dhe kanë probleme me shëndetin, me përdorimin e teknologjisë dhe përdorimin e sistemit SMIL e gjithashtu kemi mungesë edhe të zyrtarit për statistika, pasi që zyrtari i cili ka qenë në këtë funksion është pensionuar dhe mungesë të zyrtareve ligjorë, ku aktualisht pa zyrtarë ligjorë, ku aktualisht pa zyrtarë ligjorë i kemi 4 gjyqtarë e po ashtu pritët që ky numër të rritet sepse disa nga zyrtarët ligjorë tanimë janë avancuar në pozita të ndryshme administrative brenda gjykatës e disa të tjera janë afër pensionimit.

b) Sa i përket stafit administrativ që janë punësuar kemi pasur probleme të ndryshme në organizimin e punës edhe këtë tre muaj mirëpo tanimë të gjithë respektojnë orarin, vendin dhe detyrat e punës.

c) Për Gjykatën Themelore në Gjilan së bashku me degët si problem është edhe numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve, sidomos në Degën e Vitisë për çka edhe kemi transferuar 6 gjyqtarë me qëllim për ti arritur objektivat e gjykatës.

d) Një sfidë tjetër për lëndët penale është mungesa e prokurorëve si në qendër ashtu edhe në Degët Kamenicë, Viti dhe Novobërdë, ku ka mungesë të theksuar të prokurorëve dhe për këtë çështje Kryetari i Gjykatës ka biseduar edhe me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Gjiilan, ku i njëjti na ka njoftuar se pa u bërë plotësimi i vendeve të lira në këtë prokurori nuk mund të përmirësohet gjendja por tanimë në këtë prokurori janë emëruar 4 prokurorë me mandat fillestar dhe presim që në vijim kjo gjendje të përmirësohet.

e) Sa i përket Sistemit SMIL, ne më lartë i kemi paraqitur statistikën, por të njëjtat nuk janë të sakta sa i përket ngarkesës së gjyqtarëve dhe gjykatës në përgjithësi dhe në vazhdimësi me zyrtarët e SMIL-it dhe personat përgjegjës të SKGJK-së kemi bërë përpjekje të eliminojmë këto gabime në raporte statistikore dhe gabime të tjera, por deri në këtë moment nuk kemi arritur dhe padyshim që paraqitet si problematik në punën ditore të gjykatës;

f) Sa i përket teknologjisë kemi mungesë të printerëve funksional, nëpër zyre të stafit (gjyqësore dhe administrativ), gjithashtu ka probleme të vazhdueshme edhe nëpër salla të gjykimeve përkundër se tanimë pranë gjykatës tonë është bërë instalimi i pajisjeve audio vizuale në njerën prej sallave të gjyqimit e po ashtu edhe në disa të tjera janë ndërruar pajisjet kompjuterike.

VI. Propozimi i hapave riparues

Kërkojmë nga KGJK dhe SKGJK-ja që të rekrutoj gjyqtarë për këtë Gjykatë dhe degët e saj, të shpall konkurs për zyrtar ligjor dhe për përkthyes gjyqësor për Degën e Kamenicës, si dhe të organizoj trajnime për stafin administrativ dhe për bashkëpunëtor profesional, në veçanti trajnime për shkrim dhe arsyetim ligjor.

VII. Të arriturat

Në tremujorin e dytë në secilin departament – divizion mund të konsiderojmë se ka pasur lëvizje pozitive dhe përpjekje maksimale që të përfundohen sa më tepër lëndë në raport me vitin paraprak, ka pas rezultate në respektimin e orarit, vendit dhe detyrat e punës nga të gjithë të punësuarit në këtë Gjykatë.

VIII. Përfundimi

Në bazë të dhënave statistikore nuk mund të jemi i kënaqur, por siç thash më lartë në vazhdimësi bëjmë përpjekje, kërkojmë, bisedojmë që stafi administrativ të jetë më efektiv, kurse sa i përket gjyqtarëve nga të njëjtit në vazhdimësi kemi kërkuar që të caktojnë – procedojnë lëndë sa më tepër që është e mundur, të caktojnë lëndët e rigjyimit dhe të trajtojnë çështjes sipas arritjes në gjykatë dhe konsideroj që në muajt në vazhdim pas ndryshimit të planit të punës do të ketë edhe më tepër rezultate për përfundimin e lëndëve.

Sa i përket, transparencës, llogaridhënies, objektivitetit, paanshmërisë dhe pavarësisë, në vazhdimësi kërkojmë nga gjyqtarët dhe të njëjtit i inkurajojmë që të jenë të pavarur dhe të paanshëm në trajtimin e çështjeve, pasi që kthimi i besimit në Gjykatën Themelore në Gjilan është objektivi ynë kryesor dhe kjo mund të arrihet me punë dhe angazhim maksimal nga gjithë punonjësit e kësaj gjykate.

Nënkryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, Rilind Sermahaj _____

Me datë 30.06.2023

